

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika® WT-200 P

ADITIV KRISTALIN DHE HIDROIZOLUES PËR BETONIN REZISTUES NDAJ UJIT



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® WT-200 P është aditiv hidroizolimi që kombinon rezistencën ndaj ujit dhe kristalin që përdoret për të reduktuar përshkueshmërinë e betonit dhe për të përmirësuar aftësitë vetëpërmirësuese të betonit.

### PËRDORIMET

Sika® WT-200 P është formuluar posaçërisht për të prodhuar beton të hidroizoluar me cilësi të lartë. Betoni i trajtuar me Sika® WT-200 P përdoret si pjesë e sistemit Sika® Watertight Concrete.

Sika® WT-200 P mund të përdoret në çdo strukturë të papërshkueshme nga uji nën / brenda / mbi tokë si:

- Bodrume
- Garazhe parkimi
- Dhoma shërbimi/ fabrike
- Tunele
- Pishina
- Struktura ujëmbajtëse
- Diga
- Struktura trajtimi të ujërave të ndenjtur
- Mjedise tregtare nëntokësore (qendra tregtare, qendra transporti etj.)

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Sika® WT-200 P konsiston në një përzierje çimentoje, amino alkoolesh dhe lëndësh mbushëse. Këto materiale aktive do të formojnë një material të patretshëm nëpër poret dhe strukturën kapilare të betonit dhe izolojnë në mënyrë të përhershme betonin kundër depërtimit të ujit dhe lëngjeve të tjera. Përveç kësaj, formula e veçantë dhe përbërësit e Sika® WT-200 P shtojnë vetitë vetëpërmirësuese të betonit dhe përmirësojnë aftësinë kundër plasaritjeve të betonit. Sika® WT-200 P ka avantazhet dhe përfitimet e mëposhtme:

- Redukton depërtimin e ujit nën presion
- Redukton absorbimin e ujit
- Përmirësim i vetive vetëshëruese të betonit
- Përmirësim i rezistencës kundër sulmit kimik
- Transmetim i reduktuar i avujve

### MIRATIME / STANDARDE

Plotëson kërkesat e EN 934 – 2, Tabela 9

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Përzierje çimentosh, amino alkoolesh dhe lëndësh mbushëse
<b>Ambalazhi</b>	qese të tretshme 1.75 kg thes 18 kg
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Pluhur gri
<b>Jetëgjatësia</b>	12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të papapur dhe të padëmtuar.
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Të ruhet në temperatura midis 5°C dhe 30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, lagështia, ngrica dhe kontaminimi.
<b>Dendësi vëllimore (bulk density)</b>	~750 kg/m <sup>3</sup>

## TË DHËNA TEKNIKE

<b>Udhëzime për betonimin</b>	Duhet të zbatohen rregullat standarde të praktikës së betonimit të saktë në lidhje me prodhimin dhe hedhjen e betonit. Duhet të kryhen testime laboratorike përpara betonimit në kantier, sidomos nëse përdoret një recetë e re apo nëse do prodhohen elemente të reja betoni. Betoni i freskët duhet të trajtohet në mënyrë të përshtatshme dhe trajtimi të aplikohet sa më herët të jetë e mundur.
<b>Përbërja e betonit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Për beton të hidroizoluar: Receta e betonit varet nga kërkesat lokale dhe/ose standardet lokale për sisteme betoni të papërshkueshëm nga uji.</li> <li>▪ Për beton të papërshkueshëm nga uji Sika®: Sika® WT-200 P është formuluar për përdorim në beton me përmbajtje minimale lidhësi prej 350 kg/m<sup>3</sup> dhe raport maksimal ujë/lidhës 0.45. Doza e reduktuesit të ujit/superplastifikuesit duhet vlerësohet në varësi të recetës specifike në mënyrë që të arrihet një kategori konsistence S3 / F4 (EN 206-1).</li> <li>▪ Rekomandohet gjithmonë kryerja e testimeve laboratorike për të vlerësuar dhe konfirmuar reduktimin aktual të ujit dhe kategorinë e konsistencës.</li> </ul>
<b>Ndikimi në mpiksje</b>	Përbërja kimike dhe fizike e përbërësve, betoni, Sika® WT-200 P dhe temperatura e ambientit mund të ndikojnë mbi kohën e mpiksjes së betonit.

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

<b>Doza e rekomanduar</b>	1–2 % e Sika® WT-200 P për peshë lidhësi (binder)
<b>Kompatibiliteti</b>	Sika® WT-200 P mund të kombinohet me produkte të tjera Sika. Shënim: Kryeni gjithmonë testime përpara se të kombinoni produktet në mikse specifike dhe kontaktoni me shërbimin teknik Sika për më tepër informacione dhe këshilla.
<b>Mënyra e aplikimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sika® WT-200 P shtohet gjatë kohës së prodhimit tek betoni.</li> <li>▪ Në varësi të funksionit, hidhet tek uji i përzierjes për të formuar një llaç shumë të hollë që hidhet tek betonierja.</li> <li>▪ Ose shtoni Sika® WT-200 P tek agregatet e imëta dhe kokërrtrasha. Agregatet dhe Sika® WT-200 P duhet të përzihen plotësisht për rreth 120 sekonda përpara shtimit të çimentos dhe ujit të përzierjes.</li> <li>▪ Rekomandohet një kohë përzierjeje e lëngët, e cila varet nga kushtet e përzierjes dhe performanca e betonieres, prej të paktën 60 sekondash.</li> <li>▪ Për të shmangur ujin e tepërt tek betoni, doza përfundimtare duhet të fillojë vetëm pas 2/3 të kohës së përzierjes së lëngët.</li> <li>▪ Raporti ujë/lidhës dhe kontrolli i konsistencës mbetet përgjegjësi e prodhuesit të betonit. Rekomandohen testime laboratorike për të vlerësuar dhe konfirmuar rrjedhshmërinë dhe punueshmërinë aktuale.</li> </ul>
<b>Kufizime</b>	Zëvendësimi i çimentos lejohet deri në sasinë 40 % të përmbajtjes totale të lidhësit (hi fluturues-flying ash- / GGBFS / tym silici).

### KUFIZIME

Përdorimi i Sika® WT-200 P duhet bërë bazuar mbi një recetë të miratuar dhe duke testuar burimet vendase të materialeve.

### BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika® WT-200 P  
Shkurt 2019, Botimi 01.01  
021403011000000094

SikaWT-200P-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf

